



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

Nr. 2323 Prot.

Tiranë, më 19.03.2020

**UDHËZIM**

Nr. 05, Datë 19.03.2020

**“MBI LEHTËSIMIN E PROCEDURAVE TË PËRFTIMIT TË BARNAVE ME RIMBURSIM PRANË BANESËS PËR PACIENTËT E GRUPMOSHËS MBI 65 VJEÇ”**

Në zbatim të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Urdhrit të Kryeministrit “Për ndalimin e lëvizjes së pensionistëve”; Kontratës me dhënësit e shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor për Vitin 2020; Kontratës me subjektet farmaceutike për vitin 2019 dhe me qëllim mbrojtjen e shëndetit të të moshuarve nga infeksioni i shkaktuar nga Virusi COVID-19,

**U D H Ë Z O J:**

1. Farmacitë / Agjencitë Farmaceutike të rrjetit të hapur, të cilat kanë kontratë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në bashkëpunim me dhënësit e shërbimit shëndetësor publik parësor të mundësojnë dërgimin e barnave pranë banesave për pacientët kronikë, të cilët janë të moshës 65 vjeç e lart, të cilët jetojnë vetëm dhe nuk kanë familjarë / të afërm që kujdesen për ta, përgjatë periudhës së rrezikut nga pandemia e shkaktuar nga Virusi COVID-19.
2. Në vijim të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Fondit me Nr. 4, datë 12.03.2020 “Mbi kufizimin e lëvizjes së pacientëve në sistemin shëndetësor publik parësor” mjeku i përgjithshëm / mjeku i familjes i komunikon (me telefon, sms apo mënyra të tjera elektronike, si p.sh: skype, whatsapp, etj.) kodin / kodet e recetave pacientit.
3. Lista emërore e pacientëve mbi 65 vjeç, e cila do të ketë informacion mbi farmacinë / agjencinë farmaceutike e rrjetit të hapur ku pacienti ka ekzekutuar recetat e fundit me rimbursim si edhe numri i kontaktit për farmacinë / agjencinë farmaceutike përkatëse do të sigurohen (në rrugë elektronike) nga Drejtoritë Rajonale / Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për çdo Qendër Shëndetësore / Mjek Familje të kontraktuar nga ana e tyre.

4. Në rastet kur pacienti / familjari i tij, MPF, farmacisti/ ndihmës farmacisti dakortësohen përsa më sipër, nga ana e farmacisë / agjencisë farmaceutike kryhet ekzekutimi i recetës / recetave me rimbursim duke zbatuar të njëjtat procedura (dhe plotësuar dokumentacionin përkatës) si në rastet kur pacienti paraqitet pranë ambjenteve të farmacisë/agjencisë farmaceutike.
5. Farmacisti / ndihmës farmacisti përgatit barin/barnat për pacientin sipas recetës / recetave të ekzekutuara dhe të printuara nga sistemi e-RX dhe realizon dërgimin e tyre pranë vendbanimit të pacientit.
6. Në momentin e dorëzimit të barit / barnave pacientit do të kryhet edhe pagesa apo bashkëpagesa (nëse do të ketë të tilla), kundrejt zbatimit të të gjitha procedurave financiare apo tatimore në fuqi dhe do të nënshkruhet në pjesën e pasme të recetës / recetave nga pacienti marrja në dorëzim e barit / barnave për të siguruar gjurmueshmërinë e tyre.
7. Gjithashtu gjatë procesit të dorëzimit të barit / barnave duhet të respektohet në mënyrë rigoroze perimetri i sigurisë dhe distanca midis pacientëve dhe ofruesve të këtij shërbimi të jetë me masa mbrojtëse dhe jo më pak se 1.5 metër nga njëri-tjetri.
8. Ngarkohen Drejtoritë Rajonale / Degët e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të cilët në koordinim me Drejtoritë Rajonale / Njësitë Vendore të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të marrin masat për zbatimin e këtij Udhëzimi dhe njoftimin e të gjithë dhënësve të shërbimit shëndetësor publik parësor dhe farmacive / agjencive farmaceutike të rrjetit të hapur të kontraktuar nga ana e tyre.
9. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet përgjatë gjithë kohës së rrezikut nga pandemia e shkaktuar nga Virusi COVID-19.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Rudina Degjoni**

